



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr. 18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 22 Prot.

Tiranë më 12.01.2016

V E N D I M

Nr. 4, datë 12.01.2016

“Për fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2016, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2016”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar subjektet që do të kontrollohen gjatë vitit në vazhdim, si dhe objektin e mbikëqyrjes.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka procesi i pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, me qëllim që të garantohen parimet e pranimit në shërbim civil, ndër të cilët, atë të shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, si dhe për të mundësuar një proces përzgjedhës transparent e të drejtë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, Komisioneri ka parashikuar përfshirjen e procesit në një mbikëqyrje të përgjithshme.

Për këtë arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2016, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim realizimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, në institucionet e administratës shtetërore,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në subjektin, Departamenti i Administratës Publike sipas objektit dhe anekseve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi, për pozicionet e punës:

- 1 (një) pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”;
- 29 (njëzet e nëntë) pozicione vakante të nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015, me Vendimin nr. 169, datë 25.02.2015, “Për planin vjetor të pranimi në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2015”, të Këshillit të Ministrave, në institucionet e administratës shtetërore sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe me Vendimin nr. 878, datë 30.10.2014, “Për hapjen e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2015”, të Këshillit të Ministrave.

2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

- | | |
|---------------------------|--|
| 1. Altin SHUMELI | Drejtor i Mbikëqyrjes
(Në cilësinë e drejtuesit teknik) |
| 2. Saimir MUÇMATAJ | Inspektor
(Përgjegjës grupi) |
| 3. Matilda IDRIZAJ | Inspektor
(Anëtar) |
| 4. Ina SKËNDERI | Specialist IT
(Anëtar, në cilësinë e përpunuesit të të dhënave) |

3. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e pranimi të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, në institucionet e administratës shtetërore.

4. Grupi i mbikëqyrjes, duhet të përfundojë procesin e mbledhjes së të dhënave në institucion, me përfundimin e procedurave të pranimi.

5. Pas raportimit tek Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i mbikëqyrjes, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projektraportit të mbikëqyrjes, i cili pas 7 ditësh do t’i paraqitet Komisionerit për miratim dhe më tej, do t’i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t’u njohur me gjetjet, duke i lënë 5 ditë kohë për të përgatitur observacionet.

6. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve, e pas 3 ditëve, do t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes, në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR INSPEKTIMN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tirana, Shqipëri

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 22/1 Prot.

Tiranë më, 12.01.2016

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONERI

PROGRAM MBIKËQYRJE

(Për mbikëqyrjen e përgjithshme në administrimin e shërbimit civil në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Departamenti i Administratës Publike.
- 2. Objekti i mbikëqyrjes:** Mbikëqyrje e përgjithshme mbi zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, për pozicionet e punës:
- 1 (një) pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”;
 - 29 (njëzet e nëntë) pozicione vakante të nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015, me Vendimin nr. 169, datë 25.02.2015, “Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2015”, të Këshillit të Ministrave, në institucionet e administratës shtetërore sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe me Vendimin nr. 878, datë 30.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2015”.
- 3. Baza ligjore:** Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.
- Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Rregullorja “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

4. Periudha e mbikëqyrjes: Mbikëqyrja do të përfshijë veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse (DAP) dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në procedurat e konkurrimeve, sipas objektivit të mbikëqyrjes.

5. Afati i mbikëqyrjes: Mbikëqyrja do të fillojë në institucion në datën **16.01.2016** dhe do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar, nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

6. Procedura që do të ndiqet: Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet procesverbal administrativ dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

- 1. Altin SHUMELI** Drejtor i Mbikëqyrjes
(në cilësinë e drejtuesit teknik)
- 2. Saimir MUÇMATAJ** Inspektor
(Përgjegjës grupi)
- 3. Matilda IDRIZAJ** Inspektor
(Anëtar)
- 4. Ina SKËNDERI** Specialist IT
(Anëtar, në cilësinë e përpunuesit të të dhënave)

8. Dokumentimi i rezultateve të mbikëqyrjes:

Në përfundim të procesit të këqyrjes dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, do të përgatitet projektraporti i mbikëqyrjes, me të cilin do të njihen personat përgjegjës për t'i dhënë atyre mundësinë e sqarimeve dhe të paraqitjes së observacioneve. Më pas do të hartohet raporti përfundimtar i mbikëqyrjes, i cili do t'i dërgohet institucionit, i shoqëruar me rekomandimet dhe paralajmërimet përkatëse për të rregulluar ligjshmërinë.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.
2. Respektimi i kërkesave ligjore gjatë procesit të pranimit për pozicionet e punës objekt mbikëqyrje, në të gjitha fazat e tij duke përfshirë:
 - a) Procedurën e përzgjedhjes së dy përfaqësuesve nga ASPA, si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes së TND;
 - b) Publikimi i dokumenteve që kanë lidhje me procesin:
 - Shpallja e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND);
 - Shpallja e kandidatëve të kualifikuar për të zhvilluar konkurrimin;

- Shpallja e kandidatëve fitues në listën përfundimtare të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes.
- c) Faza e verifikimit paraprak;
- d) Faza e vlerësimit të kandidatëve, duke përfshirë:
 - Vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
 - Testimi me shkrim;
 - Intervistën e strukturuar me gojë.
- dh) Të gjitha veprimet e tjera administrative dhe aktet administrative të nevojshme për realizimin e procesit të mbikëqyrjes.

3. Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të punës për të përfunduar këtë proces:

- Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët për të marrë pjesë në këto konkurrime;
- Dokumentacioni që do të krijohet në vijim të procesit dhe që ka lidhje me konkurrimet objekt mbikëqyrje;
- Materiale dhe dokumente të tjera, të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për realizimin e mbikëqyrjes.

DREJTORIA E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arbana BASHA